



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 235/2 Prot.

Pogradec, më 21.01.2022

VENDIM

Nr. 04, Datë 20.01.2022

PER MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2022.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike":

**KËSHILLI I BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2022.

Familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik I Ndhmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, nuk kanë automjet, nuk kanë asnjë punësuar dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të përfitojnë familjet me shumë fëmijë, me nevoja sociale të theksuara, të cilat nuk kanë dalë fituese nga sistemi.
- b. Gratë e veja me fëmijë.
- c. Gratë e divorcuara me fëmijë.
- d. Beqarët të ngelur vetëm, në moshë mbi 40 vjet, të pamundur për të punuar.
- e. Familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuara.
- f. Familjarë në prag pensioni që nuk kanë mundësi punësimi.

**KRYETAR I KËSHILLIT
Sotirag MANGËRI**

